



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE  
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr.2188 Regj  
Nr.385 Prot

Tiranë, më 13.02.2024

URDHËR  
“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit ✓  
Adresa: Tirane  
Drejtuar: “AL-POINT” sh.p.k me nipt L0201022D  
Adresa: Rruga Myslym Keta, Shish Tufine, prane Poliklinikes Shtetore, Dajt, Tirane  
Per djeni: “PEPA GROUP” Sh.p.k. Nipt L42215009L  
Adresa: Autostrada Tirane Durres, Km. 6. Kashar, Tirane.

Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyres Permbarimore Private “REAL BAILIFF SERVICE”, në referim të Urdherit të Ekzekutimit “Vendimi Nr.13867Akti, date 28.12.2023, i Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane”, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.2188, Datë 15.01.2024 kërkesën e kreditorit “PEPA GROUP” Sh.p.k. Nipt L42215009L ndaj debitorit “AL-POINT” sh.p.k me nipt L0201022D, në lidhje me titullin ekzekutiv “Fature tatimore e shitjes me Nr.serial 96868160 date 02.03.2021 – e vijuese deri ne fatura tatimore e shitjes me Nr.serial 8205cd01-899c-40ec-btbb-59a10b6b2blc date 05.09.2021, total 37 (cope) fatura”.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr.97 Prot, Datë 15.01.2024, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdheri i Ekzekutimit “Vendimi Nr.13867Akti, date 28.12.2023, i Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane” në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

Debitori “AL-POINT” sh.p.k me nipt L0201022D, nuk i eshte përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit per ekzekutim vullnetar te detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit “AL-POINT” sh.p.k me nipt L0201022D, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues te K.Pr.Civile, si dhe të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, me qellim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore “AL-POINT” sh.p.k me nipt L0201022D me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE “REAL BAILIFF SERVICE”  
PËRMBARUESI GJYQËSOR

ERIS SOTIRI

